



Paralajmërim ekonomik evropian i Komisionit Evropian



Ekonomia evropiane hyn në vitin e saj të katër për ringjallje dhe rritja vazhdon me shkallë mesatare. Në të njëjtën kohë, pjesë e madhe e ekonomisë botërore ballafaqohet me sfida të mëdha dhe rreziqet për zhvillimin evropian zmadhohen.

Komisionin evropian më 4 shkurt këtë vit e prezantoi paralajmërimin e sa ekonomik dimëror. Sipas të cilës pamjet e përgjithshme për rritje në mënyrë të parëndësishme janë ndryshuar në lidhje me vjeshtën të vitit 2015. Është zmadhuar rreziku se rritja do të jetë më e ngadalshme nga e parapara si rezultat i faktorëve të jashtëm. Parashikohet shkalla e rritjes në eurozonë të zmadhohet në 1,7% këtë vit prej 1,6% të vitit të kaluar, që të hipet në 1,9% në vitin 2017. Rritja ekonomike e UE-së parashikohet të mbetet stabile në 1,9% në vitin 2016 dhe të zmadhohet në 2,0% në vitin 2017.

Faktorë të caktuar në të cilin mbështetet rritja pritet të jenë më të forta dhe të zgjasin më gjatë sa që parashikohet. Ndër ato faktorë janë çmimet të ulëta të naftës, kushte të volitshme për financim dhe kursi i ulët revizor i euros. Rreziqet për ekonominë qëndrojnë edhe më tej dhe të vërehen këto sfida: rritje më e ngaltë në Kinë dhe ekonomi të tjera tregjet të të cilave janë në fazë të formimi, aktiviteti i dobët i tregtisë globale, si dhe pasiguria gjeopolitike dhe politike.

Në vitin 2015, rezultatet ekonomike në të gjitha vendet-anëtare të UE-së ose janë të përmirësuar ose qenkan stabile. Pritet deri në fund të vitit 2017 të gjitha vendet-anëtare të shënojnë rritje ekonomike. Megjithatë, shkallë të rritjes të BPV-së edhe më tej dukshëm do të dallohen që ka të bëjë me karakteristikat strukturore.

Konsumimi privat pritet të mbetet lëvizëse kryesor i rritjes në vitin 2016 dhe 2017, e përkrahur me përmirësimin e tregut të punës dhe zmadhim të të hyrave reale në dispozicion.

Punësimi pritet të vazhdojë te ritet në mënyrë modeste. Shkalla e papunësisë në eurozonë pritet të zvogëlohet prej 11% në vitin 2015 në

10,5% në vitin 2016v dhe 10,2% në vitin 2017. Papunësia në UE duhet të zvogëlohet prej 9,5% në vitin 2015 në 9,0% këtë vit dhe 8,7% në vitin e ardhshëm 2017.

Deficiti i përgjithshëm i pushtetit qendror në eurozonë pritet të zvogëlohet edhe më shumë duke u falënderuar aktivitetit më të fortë ekonomik dhe në masë më të madhe zvogëlim të shpenzimeve për kamatë.

Në eurozonë, deficiti i pushtetit qendror pritet të zvogëlohet në 2,2% nga BPV-ja në vitin 2015 (2,5% në UE) dhe duhet të zvogëlohet në 1,9% nga BPV-ja këtë vit (2,2% në UE) dhe 1,6% nga BPV-ja në vitin 2017 (1,8% në UE).

Inflacioni vjetor në eurozonë ishte vetëm pak mbi zeron në fund të viti 2015, që kryesisht ka të bëjë me rënien e mëtejme të çmimeve të naftës. Për vitin 2016, inflacioni vjetor në eurozonë parashikohet në vetëm 0,5%. Inflacioni pritet gradualisht të arrijë 1,5% në vitin 2017.

Me pikëpamjet të përqësuar të ekonomisë globale, shëndoshja e ekonomisë globale (me përjashtim të UE-së) parashikohet të jetë më e ngadalshme sesa e pritura. Rritja globale në vitin 2015 është më e dobët nga viti 2009. Gjatë viti 2016 rritja e eksportit në eurozonë duhet të përshpejtohet, pas nivelit mesatar në gjysmën e dytë të viti 2015 për shkak të depreciacionit të euros, shpenzimet të ulëta të punës dhe zmadhimi gradual i kërkesës të jashtme.

Kjo prognozë i merr parasysh të gjitha të dhënat relevante dhe faktorë, duke përfshirë supozime për politikat qeveritare deri më 22 janar 2016. Në projeksionet nuk janë marrë parasysh ndryshimi i politikës. Kjo prognozë ekonomike bazohet në grumbull të parashikimeve të jashtme në lidhje me kurset, shkallët të kamatës dhe çmimet të mallrave.

Komisioni duhet ta azhurnojë prognozën e sajë ekonomike në maj të viti 2016 .

http://ec.europa.eu/economy_finance/eu/forecasts/2016_winter_forecast_en.htm

Përmbajtja e lajmeve:

Paralajmërim ekonomik evropian i Komisionit Evropian	1
Aktivitetet e kuvendit	2, 3
Në fokus të Parlamentit Evropian	4
Samit i jashtëzakonshëm i vendeve të grupit të Vishegradit	5
Komisioni Evropian prezantonte pako të sigurisë për energji të qëndrueshme	5
Bullgaria më e ngadalte në reformat e jurisprudencës nga	6
10 milionë euro plotësuese për ballafaqim me krizën e migrantëve	6
Në pritje të referendimit britanik	7
Lubjana - Qytet i gjelbër evropian për vitin 2016	8
UE kalendar mars 2016	8

Konsumimi privat pritet të mbetet lëvizëse kryesor i rritjes në vitin 2016 dhe 2017, e përkrahur me përmirësimin e tregut të punës dhe zmadhim të të hyrave reale në dispozicion.



Këshilli nacional për eurointegrimë më 17 shkurt 2016 e mbajti mbledhjen e 14-të në të cilën debatonte për Propozim-rezolutën e Parlamentit evropian për Raportin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2015 e parashtruar nga eurodeputeti dhe raportues për Republikën e Maqedonisë, z. Ivo Vajgall. Në debatin në mbledhjen u sugjerua në nevojën nga përmirësimi i tekstit të Propozim-rezolutës dhe amendamenteve nëpërmjet shfrytëzimit të mekanizmave të ndryshëm të ndarjes të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Misioni i Republikës së Maqedonisë në Bruksel, Mbretëria e Belgjikës. Potencohej nevoja në të ardhme Kuvendi me konsensus të ndërtojë qëndrim të përbashkët për propozim-rezolutën në Parlamentin Evropian të cilat kanë të bëjnë me Republikën e Maqedonisë dhe për të njëjtat të debatohet në mbledhje të trupave kompetent të kuvendit. Në mbledhjen e Këshillit bëhej fjalë edhe për nevojën për avancim të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Këshillit Nacional për Eurointegrimë. Në këtë drejtim ishte biseduar për mundësinë propozim-ligji në të ardhme Ministria ta dorëzojë edhe te Këshilli nacional, me qëllim të shtohet mundësi Këshilli të ndërtojë mendim dhe qëndrim për dokumentin si dhe rreth mundësive për ndarje për përmirësim të tekstit.



Këshilli nacional për eurointegrimë më 12 shkurt 2016 organizonte debat publik në temë "Gejmingu si veprimtari komerciale". Në debatin publik ishin nxjerrë numër i madh i mendimeve dhe qëndrimeve prej të cilave si poena kyç mund të shikohet se: ka nevojë gejmingu të njoftohet si e-sport me qëllim të marrë trajtim adekuat institucional; ekziston nevojë nga përkrahja nëpërmjet federate të veçantë e cila do t'i përfaqësoj interesat të gejzërëve; nevojë për furnizim zë akreditimeve dhe licenca; gejmingu mund të gjejë zbatim adekuat në arsim veçanërisht në procesin mësimor për tejkalimin e programit mësimor; gejmingu mund dukshëm ta përmirësojë tejkalimin e grupi të aftësive (punë ekipore, mësim të gjuhëve të huaja, qasje në zgjedhje të problemeve, vetëdije gjinore dhe të tjera); gejmingu nëpërmjet pjesëmarrje në turnirët ndërkombëtar është mundësi e shkëlqyeshme për popullarizim të Republikës së Maqedonisë në nivel ndërkombëtar; gejmingu hap mundësi të mëdha për biznesin dhe të njëjtat duhet të shfrytëzohen; ka nevojë gejmingu ligjërish të rregullohet dhe në mënyrë adekuate financiarisht të përkrahet; ka nevojë për organizim zë më shumë debateve në të ardhme dhe për zmadhim të vetëdijes publik te qytetarët për këtë veprimtari; problemi i sigurisë dhe

mbrojtjes të të dhënave personale është e lidhur me vetëdijen e veprimtarisë-gejming.

Këshilli nacional për eurointegrimë më 5 shkurt këtë vit organizonte debat publik për "Rolin e sektorit qytetar në procesin e integritimit evropian të Republikës së Maqedonisë". Në debatin publik u drejtua z. Fatmir Besimi, zëvendës kryeministër i Qeverisë së Republikës të Maqedonisë i angazhuar për integrimë evropiane, me ç'rast informonte se Qeveria në bazë të rregullt i konsulton organizatat qytetare për tema të rëndësishme të lidhura me veprimin e tyre shoqëror.

Në debatin publik ishin nxjerr mendime të ndryshme dhe qëndrime në lidhje me rolin dhe statusin e sektorit qytetar, për dispozitat të Ligjit për shoqata dhe fondacione të cilat e rregullojnë këtë sferë, për nevojën nga sjellje më transparente të institucioneve ndaj sektorit qytetar veçanërisht në procesin e krijimit të politikave, nevoja për destigmatizim të organizatave joqeveritare. Në prononcimin e pjesëmarrësve potencohej edhe nevoja për përforsim të bashkëpunimit të organizatave qytetare veçanërisht në nivel lokal, nevoja nga pavarësia ekonomike dhe vetëpëmbajtje të organizatave, decentralizim të qëllimeve dhe mundësi individit të marrë pjesë në krijimin e politikave shoqërore, nevoja për demonopolizim të burimeve të financimit, për qasje interdisciplinare në veprimin e organizatave joqeveritare dhe përcaktim të sferave të veprimit. Në diskutimin ishin nxjerrë edhe interpretime të ndryshme dhe kuptime çka përgjithësisht paraqet sektori joqeveritar, ndërsa bëhet fjalë edhe për reprezentimin e organizatave joqeveritare dhe legjitimitetit të nevojshëm të jesh pjesë e këtij sektori, nevoja për formim të Fondit nacional për financim, nevoja për komunikim më të madh dhe bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për rëndësinë dhe aktivitetet të sektorit joqeveritar, financimi i donatorëve të huaj, për dialogun politik në procesin e qasjes në UE, lehtësimi tatimor, si dhe për përmirësimin e procesit të miratimit të ligjeve .

<http://www.sobranie.mk>



[Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

Komisioni për çështje evropiane i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, më 12 shkurt e mbajti mbledhjen e 28 të përkushtuar Debatit publik në temë: **Prioritete urgjente të reformave për Republikën e Maqedonisë - pika 5. Medie: "Medie të pavarura dhe profesionale dhe liri të shprehjes.**

Fjalim hyrës pas temës nga debati publik kishin: ministreja kompetente për shoqëri informatike, znj. Marta Arsovska - Tomovska, edhe drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audio vizuale, z. Zoran trahçevski. Në debat merrnin pjesë: z. Dejan Georgievski nga Qendra për zhvillim të medieve, z. Klime Babunski nga Promedia, znj. Ivona Talevska nga Asociacioni maqedonas i gazetarëve - MAN, znj. Tamara Çausidis nga Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, z. Naser Selmani nga SHGM, z. Muamer Bekiri nga TV Shenja dhe deputetët, znj. Jagoda Shahpaska dhe znj. Daniella Rangellova .

Komisioni për çështje evropiane më 1 shkurt 2016 organizonte Debat publik në temë: **"Prioritete urgjente të reformave për Republikën e Maqedonisë - pika 1: sundimi i drejtësisë dhe gjyqësisë"**. Fjalim hyrës për temën nga debati publik kishin: ministri i punëve të brendshme, z. Oliver Spasovski, kryetar i Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, z. Branko Ushkovski, kryetar i Këshillit të prokurorëve publik, z. Petar Anevski dhe zëvendësi i prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë, znj. Vaska Bajramovska.

Diskutuesit u përqendruan në gjendjet aktuale në sferën e sundimit të drejtësisë dhe gjyqësisë, me ç'rast ishin shprehur konstatime dhe mendime në lidhje me avancimin e mëtejshëm të bazave fundamentale të sundimit të drejtësisë dhe gjyqësisë, ndërsa me të edhe të demokracisë funksionale, si një nga kushteve të rëndësishme për qasje të vendit në UE .

<http://www.sobranie.mk/>



KOSAK si kontribut në ndërtimin e frymës pozitive konstruktive në Unionin Evropian.

Më 7 dhe 8 shkurt 2016 në Hag, Holandë, në korniza të kryesimit Holandez me Unionin Evropian u mbajtën takime përgatitor të kryetarëve të Komisioneve për çështje evropiane në vendeve anëtare të Unionit Evropian (KOSAK). Në takimin morën pjesë znj. Shpresa Hadri, deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe anëtare e Komisionit për Çështje Evropiane. Pjesa e punës në takim filloi me fjalimin e znj. Anki Brokers - Knoll, kryetare e Senatit të Mbretërisë së Holandës, e cila e theksoi rëndësinë e këtij takimi shumëvjeçar dhe tradicional i cili në masë të jashtëzakonshme kontribuuan në ndërtimin e frymës pozitive konstruktive në Unionin Evropian, prodhuan dokumente të rëndësishme për qytetarët evropian dhe këmbëhen mendime dhe vizione për funksionim të mëtejshëm të mirë të parlamenteve nacionale dhe Unionit Evropian në tërësi. Takimi vazhdoi me debat produktiv për punën e EVROPOL, i cili u zhvillua në diskutim për bashkëpunimin ndërmjet parlamenteve nacional dhe institucionet tjera të Unionit Evropian, debat për kërcënimin nga terrorizmi në Union, për valën e migrantëve me të cilin ballafaqohen vendet anëtare të Unionit, ndër të cilat edhe Republika e

Maqedonisë dhe shumë tema tjera të rëndësishme për Unionin. Në margjinat të takimit znj. Shpresa Hadri e shfrytëzojë takimin të takohet me kolegët e vet nga parlamentet nacionale të vendeve anëtare të Unionit, të këmbëjnë mendime dhe përvoja ndërmjet veti, të bisedojnë për situatën politike momentale në Republikën e Maqedonisë, por edhe në Union, që të pajtohen se këto takime janë jashtëzakonisht të dobishme për këmbimin e informatave të tilla .

<http://www.sobranie.mk/>



Sesion plenar 1-4 shkurt 2016



Kryetari i Bankës qendrore evropiane, Mario Dragi në debat me anëtarët të Europarlamentit theksoi se banka do ta revidojë pozitën monetare në mars këtë vit në mars të këtij viti dhe sugjeroi në ndryshimet në kushte në të cilat punon Banka. Nga njëra anë është mesatare ringjallja e euroekonomisë - që ka të bëjë me kërkesën e vendit, por nga ana tjetër është vërejtur rritje të rreziqeve negative për shkak të gjendjes të pavarur për mundësitë të reja për rritje të tregut, jostabiliteti në tregjet e mallit të krizave politike.

« Rezoluta për Republikë e Maqedonisë për Raportin e KE-së për vitin 2015, nga raportuesi eurodeputeti Ivo Vajgll, me 42 vota "për" dhe 9 "kundër" u miratua në seancën e Komitetit për punë të jashtme të PE (AFET) e mbajtur më 29.02.2016.

Eurodeputetët dhe eurokomesari për tregji, znj. Sesilija Mallmstorm debatuan për opsionet të mundshme të veprimi të UE-së në krahasim me Kinën. Eurodeputetët ftuan në instrumente efikase antidamping dhe insistonin të lejohet të kushtohet rëndësi e veçantë e sektorit për anëtare të UE-së, i cili për momentin është "në gjunjë" për shkak të konkurrencës jolojale nga Kina.

Në rezolutën e miratuar nga ana e Parlamentit Evropian kërkoheshin Komisionin evropian të përpiloi strategji për barazi gjinore dhe të drejtë të grave (2016-2020). Eurodeputetët debatuan për ballafaqimin me maltretimin seksual dhe dhunës nbi grave në hapësirat publike.

Në fjalimin e seancës plenare kryetari i Estonisë, Tomas Hendrik Illves e ftoi UE-në të veprojë e vendosur në lidhje me krizën e migrantëve.

Parlamenti evropian e lejoi platformën evropiane për përmirësim të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të UE-së në ballafaqimin me punës të paparaqitur, e cila përbënë 18% nga BPV-ja e UE-së.

Komisari i angazhuar për çështje ekonomike Pjer Moskoviç i prezantonte propozimet të Komisionit për luftë kundër evazionit korporativ tatimor.

Në 3 shkurt eurodeputetit i lejuan rekomandimet të Parlamentit evropian për bisedimet rrjedhëse për tregti sipas Marrëveshjes për shërbime (TiSA). Në bisedat janë përfshirë Unioni Evropian dhe 22 vende partnere të Organizatës botërore të tregtisë. Me marrëveshjen eurodeputetët dëshirojnë të lehtësohet qasja e kompanive evropiane në tregjet ndërkombëtare, derisa bëhet mbrojtje e bazave të shërbimeve publike.

Në debatin plenar për Shengen, eurodeputetët kërkuan UE-ja ta tejkalojë qëndrimin e saj të paralizuar dhe ndarje dhe në mënyrë efikase të menaxhohet me migrimin dhe ardhjen e migrantëve.

debati i gjerë ishte i hapur për çështjen për ardhmërinë e vendit të Britanisë së Madhe drejtpërdrejtë pas paraqitjes të propozimit për marrëveshje të re me vendin nga ana e Donalld Tusk, kryetari i Këshillit Evropian. Në debatin, shumica e eurodeputetëve theksuan se mbetja e Britanisë së Madhe në UE do të jetë zgjedhje më e mirë edhe për vet shtetin dhe të Unionit.

Sesion plenar 24-25 shkurt 2016

Eurodeputetët debatuan për ciklin vjetor të koordinimit të politikave ekonomike në korniza të UE-së. Nga ana e komisioneve parlamentare ishin përgatitur raporte në të cilat ftoheshin në ndërmarrje të reformave strukturore të cilat do të krijojnë vende pune dhe do të ndikojnë në zmadhimin e produktivitetit.

Udhëheqësit të grupeve më të mëdha politike në parlament e përshëndetën marrëveshjen UE - Britani e Madhe. Gjatë kohës së debatit plenar për rezultatin e samitit të para do kohe të UE-së me kryetarin e Këshillit evropian, Donalld Tusk dhe kryetari i Komisionit Evropian, Zhan - Klod Juncker, shumë nga eurodeputetët nga Britania e Madhe shprehën argumente për dhe kundër anëtarësisë në UE.

Parlamenti i lejoi rregullat për modifikim të Portalit të UE-së për shërbime gjatë punësimit (EURES) me bazë të gjerë të të dhënave për personat të cilit kërkojnë punë dhe vende të punës në nivel të UE-së. Portali i ri "më i mençur" EURES automatikisht do t'i selektojë biografite sipas ofertave adekuate për punë. Gjithashtu, të gjitha vendet e lira të punës të shpallura nga ana e zyrave në vendet-anëtare do të jenë të kapshme përtej UE-së nëpërmjet ueb-portalin.

Në tre rezoluta të ndara ishin miratuar prioritetet ekonomike, social për Tregun e vetëm për vitin 2016. Eurodeputetët dhanë kontribut për samitin e ardhshëm ekonomik në mars, i cili do të fokusohet në zbatimin e Paktit për stabilitet dhe rritje, aspektet sociale dhe shfrytëzimi i mëtejme i potencialit ekonomik të tregut të vetëm.

Parlamenti evropian lejoi ndihmë prej 1.095.544 euro për Belgjikën të dedikuara për 412 punëtorë të shpallur për tepçicë teknologjike nga ana e dy prodhuese të qelqit, me qëllim gjetje të vendeve të reja të punës. Kjo ndihmë nga Fondi evropian për adaptimin ndaj globalizimit (EGF), megjithatë duhet të jetë e lejuar nga ana e Këshillit të ministrave të UE-së .

<http://www.europarl.europa.eu/news/en>



Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features

SAMIT I JASHTËZAKONSHËMI VËNDEVE TE GRUPIT TË VISHEGRADIT

Më 15 shkurt 2016 në Pragë e mbajt samiti i Grupit të Vishegradit në të cilin Unioni Evropian kërkoi të përgatiten plane alternative për ndërprerje të valës të migrantëve në rast të përgatitet situata e vitit të kaluar e cila do t'i kërcënojë themelet të Ue-së dhe sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Kryeministrat të Polonisë, Çekisë, Sllovakisë, Hungarisë, Bullgarisë, dhe kryetari i Republikës së Maqedonisë, dhanë përkrahje të fortë të bashkimit të përbashkët të zgjidhjes evropiane për rregullim të krizës së migracionit në bashkësi.

Në samit prioritet ishte vënë edhe në formim urgjent të Rrojës tejkuftar evropiane, zbatimi i marrëveshjes me Turqinë dhe zbatimi i tashmë hapave të kontraktuar për mbrojtje të hapësirave të shengenit, para së gjithash Greqia. Ky është konkluzioni kryesor i takimit të mbajtur në Pragë të shteteve dhe qeveri të vendeve të Katërshes të Vishegradit me pjesëmarrje të kryetarit maqedonas Gjorge Ivanov dhe kryeministri bullgar Bojko Borisov.

"Për Republikën e Maqedonisë është jashtëzakonisht e rëndësishme Unioni Evropian të investojë përpjekje maksimale që të siguroj unanimitet për çështjen me krizën e migrantëve dhe përgjigje gjithëpërfshirëse. Maqedonia në takimin në bazë të përvojës të tij ofroi edhe zgjidhje" theksoi kryetari i Republikës së Maqedonisë, dr. Gjorge Ivanov pas Samitit të rregullt të vendeve të Grupit të Vishegradit.

Në Samit ishte shënuar 25 vjetori nga formimi i grupit rajonal joformal. Kryeministrat e përsëritën përkrahjen afatgjate ndaj Republikës së Maqedonisë dhe vendet tjera të Ballkanit perëndimor në rrugën në UE, ndërsa gjithashtu edhe përkrahje për Bullgarinë dhe Rumaninë për hyrje në hapësirën e shengenit.

<https://www.euractiv.com/section/central>



KOMISIONI EVROPIAN PREZANTONTE PAKO TË SIGURISË PËR ENERGJI TË QËNDRUESHME

Më 16 shkurt 2016, Komisionin Evropian i prezantoi pakon për siguri energjetike me rekomandime për përgatitje të Unionit Evropian për tranzicion global energjetik.

Siguri energjetike është në nga themelet kryesore të Strategjisë të re evropiane e cila paraqet prioritet kyç i Komisionit.

Pakoja përfshinë spektër të gjerë të masave për përforsim të rezistencës të UE-së si pasojë e ndërprerjes furnizimit me gaz. Masat përfshijnë edhe kërkesë të energjisë të qëndrueshme, zmadhim të kërkesës dhe prodhimit të energjisë në Evropë (duke përfshirë edhe prodhimit të energjisë nga burimet të ripërtërishme), të cilat janë me potencial për zhvillim plotësues, funksionim të mirë dhe integrim të plotë me tregun e brendshëm energjetik të UE-së, si dhe diverzifikim të burimeve energjetike dhe transport alternativ.

Pakoja e masave për siguri energjetike janë dhënë në kontekst të potencialit global dhe marrëveshjes universale për ndryshime klimatike, i miratuar nga liderët botëror më 12 dhjetor 2015 në Konferencën klimatike në Paris.

Marrëveshja nga Parisi dërgoi sinjal të fortë për biznes bashkësinë dhe kreatorët të politikave ekonomike me qëllim sigurimin e energjisë të pastër me zhvillim të ripërtërishëm dhe vendosje të skenës globale energjetike dhe tranzicioni energjetik .

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-307_en.htm



E JURISPRUDENCËS NGA RUMANIA



Komisioni evropian vlerësoi se Rumania përparon në luftën me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në sferën e reformës në gjyqësi Bullgaria mbetet prapa Rumanisë.

Si problem në Rumani theksohet shkalla e lartë e paanshmërisë të disa vendime të gjykatës dhe çështje ligjdhënëse të cilat ende janë të hapura.

Numër i madh i qytetarëve të Bullgarisë dhe Rumanisë konsiderojnë se UE në mënyrë pozitive ndikon në gjyqësi dhe luftën kundër korrupsionit dhe dëshirojnë vendet e tyre të arrijnë standard si në vendet tjera anëtare të UE-së.

Rumania dhe Bullgaria nga hyrja në Unionin Evropian në vitin 2007 janë në mbikëqyrje të Komisionit Evropian në sferën e: gjyqësi, luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si pasoja të mosplotësimin të standardeve plotësisht. Për shkak të kësaj, tash në bisedimet për anëtarësi në UE kërkohet e drejtë të hapen kapitujt të cilin kanë të bëjnë me sundimin e drejtësisë. Komisioni Evropian, i cili i përcjellë reformat në Bullgari theksoi se qeveria e tashme dhe Parlamenti i Bullgarisë ka bërë hap të rëndësishëm duke miratuar strategji për reforma në disa sfera. Vlerësimi nga raporti paraprak në janar të vitit 2014 është se institucionet kyçe kanë vazhduar të punojnë

në ndryshimet në drejtorinë e cila do të ndihmojë në zbatimin e reformave në terren.

Në raportin e ri të komisionit sugjerohet se çështje të tjera të caktuara nuk zgjidhen në mënyrë të cili fut besim në institucionet, siç janë ndarja e lëndëve sipas zgjedhjes të rastësishme dhe emërimi i pozitave të rëndësishme gjyqësore për çka janë përgjegjëse institucionet nacionale.

Në luftën me korrupsionin dhe krimin e organizuar edhe më tej nuk reagohej në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sipas strategjisë. Siç theksohet, shumë pakë raste të "mëdha" zgjidhen në gjyq të cilat kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Raporti përmban një sërë rekomandimesh në sferën e pavarësisë, përgjegjësisë dhe integritetit të gjyqësisë dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Komisioni vlerëson se Bullgaria doemos duhet t'i përshpejtojë reformat dhe të tregojë rezultate në të gjitha sferat. Deri në raportin e ardhshëm të Komisionit me vëmendje do ta përcjellë përparimin e Bullgarisë para misionëve të rregullta, si dhe dialog të shpeshtë me pushtetet bullgare dhe anëtarët tjera të UE-së.

10 MILIONË EURO PLOTËSUESE PËR BALLAFAQIM ME KRIZËN E MIGRANTËVE

Unioni Evropian më 15 shkurt 2016 lejoi plotësisht 10 milionë euro ndihmë për Republikën e Maqedonisë, për përmirësim të sistemit për menaxhim kufitar dhe menaxhim me migrantët. Unioni është i përgatitur të vazhdojë tu japë ndihmë vendeve nga Ballkani Perëndimor të cilat ballafaqohen me sfida të ngjashme.

Sipas eurokemesarit për bisedime për zgjerim Johanesh Han, migrimi shkaktoi presin të madh mbi vendeve dhe UE-ja doemos duhet të mbetet e bashkuar në ballafaqimin me këtë situatë. Financimi i ri do t'u ndihmojë pushteteve të Republikës së Maqedonisë për përmirësim të menaxhimit me kufirin dhe me migrimin, si dhe përkrahje të shpenzimeve të reja në lidhje me oficerët-mysafir të dërguar nga ana e vendeve-anëtare të UE-së. Kjo përkrahje është e kompletuar në aktivitete e ndërmarra për përkrahje të Greqisë, duke përfshirë edhe nëpërmjet FRONTEKS. Në këtë kontekst, Maqedonia duhet ta përmirësojë menaxhimin me kufijtë nëpërmjet agjencisë kufitare UE-FRONTEKS.

Kjo ndihmë është veçanërisht e rëndësishme për përmirësimin e aftësisë për menaxhim me kufirin dhe hyrjeve të migrantëve, nëpërmjet kontrole sistemore dhe vëzhgim të kufirit, identifikim dhe regjistrim të

persona nga vende të treta të cilit në mënyrë legale ose ilegale e kalojnë kufirin, si dhe në luftën kundër migrimit ilegal, tregtisë me njerëz dhe përmirësimi i efikasitetit në ballafaqimin me krimin tejkufitar, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën dhe të drejtat themelore të njeriut.

Programi është i hapur edhe për vendet tjera përtej rrugës të migrantëve të cilit do të mund të ballafaqohen me sfida të ngjashme në të ardhme dhe ka për qëllim t'i përkrahë me menaxhimin me kufijtë të tyre nëpërmjet FRONTEKS - agjencia për menaxhim me kufij të jashtëm.

Në vitin 2015 në UE kanë hyrë 1.3 milionë shtetas të vendeve të treta, të cilin kanë pasur mundësi të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në UE, Norvegji dhe Zvicër. Numri më i madh i azillantëve dhe migrantëve të cilit vijnë në vendet të UE-së janë nga rajonet të Ballkanit Perëndimor. Ruta kryesore për momentin është nga Turqia kah Greqia, Maqedonia dhe Serbia .

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16

Kryeministri Britanik Dejvid Kameron shprehu kënaqësi nga marrëveshja e arritur me kryesuesit të Unionit Evropian, duke theksuar se i ka plotësuar të gjitha qëllimet e veta të bisedimeve.

Marrëveshja është pako e reformave të cilat i kërkonte Britania e Madhe para mbajtjes të referendumit në të cilin votuesit britanik do të prononcohen nëse dëshirojnë të mbeten ose, të dalin nga Unioni Evropian.

Me këtë marrëveshje, kryeministri Kameron e mban fushatën për mbetje në UE për referendumin i cili me siguri do të mbahet më 23 qershor.

Vendimi juridik obligues përmban marrje eksplicite të Britanisë së Madhe nga dispozitat të regjistruara në marrëveshjet evropiane për "Unionin së më të lidhur", mandej lëshime në pikëpamje të të drejtave sociale të punëtorëve nga vendet tjera anëtare të UE-së në Britani dhe garanci se dispozitat për unionin bankar nuk ka të shkojnë në dëm të qendrës financiare të Londrës - Siti.

Kryeministri Kameron kërkonte gjatë katër vitet e para punëtorët jobritanik të mos kenë të drejta në kompensime sociale për ndihmë ose për banim. Gjithashtu, të ndërpriten shtesat për fëmijë për fëmijët të punëtorëve të cilit kanë mbetur në vendet e tyre. Kameron arriti të marrë klauzolë mbrojtëse prej 7 vjet, e cila parashikon kufizim të kompensimeve sociale të cilat gradualisht do të hiqen. Futet indeksacion i shtesave për fëmijë - sipas standardet të shteteve në të cilat jetojnë fëmijët, ndërsa jo sipas standardet të vendit në të cilin prindërit punojnë. Ajo do të mund të zbatohet në punëtorët të sapoardhur menjëherë, ndërsa për të gjithë tjetër prej viti 2020.

Britania, gjithashtu, kërkonte mundësi grup i caktuar i parlamenteve nacional të mund të vë veto në miratimin e zonave evropiane. Është kontraktuar parlamentet kombëtare të mund të pengojnë miratim të ndonjë ligji evropian nëse për atë vendosën 55%, përkatësisht 16 prej 28 vende anëtare.

Vetëm që kryeministri Dejvid Kameron në Bruksel e arriti marrëveshjen e kompromisit me qëllim Britania e Madhe të mbetet në UE-në e reformuar dhe paralajmëroi se do të luftojë për atë, fillojë e reja e ashtuquajtur "luftë për Britaninë". Kryetari i Londrës Boris Xhonson deklaroi se do të bashkëngjitet në fushatën për Bregzit, që është sfidë e drejtpërdrejtë për kryeministrin i cili më 22 shkurt në Parlament edhe formalisht e prezantoi planin për mbajtje të referendumit për anëtarësim të mëtejshëm të Britanisë në UE më 23 qershor.

Referendumi i ndau Konservatorët të Kameronit, ndërsa pjesa më e madhe e

qeverisë së tij e përkrahu mbijetesën e UE-së, disa janë kundër edhe angazhohen për Bregzit.

Vendimi i kryetarit Xhonson, i cili nuk ka mandat të dytë si kryetar komune i Londrës edhe si shumica e shikojnë si lider i ardhshëm i partisë, i rrëzoi shpresat të Kameronit, për front të bashkuar para referendumit.

Deri tash asnjë vend nuk ka dalë nga UE-ja, ndërsa më shumë vende evropiane jashtë bllokut zbatojnë reforma të vështira në ekonomi dhe administratë që të hynë në Union.

Për dalje të Britanisë nga UE-ja nga radhët e Kameronit janë edhe ministri për drejtësi Majkëll Gouv dhe edhe disa ministra, por askush nuk ka forcë aq të madhe politike si Xhonson. Prej 23 anëtarë të qeverisë së Kameronit, 6 shpallën se do të jenë në fushatë për dalje nga UE-ja.

Edhe dy për të cilët shikohen si liderë të ardhshëm të konservatorëve, ministri i financave Xhorxh Ozborn dhe ministrja e punëve të brendshme, Tereza Mej mbeten me Kameronin dhe do ta përkrahin fushatën për Britaninë në UE.

Kryeministri britanik Kameron theksoi se gabojnë ata të cilit e përkrahin daljen e UE-së sepse mendojnë se nuk është përgjigjur si duhet në hyrjen e migrantëve. Ai shtoi se çdo marrëveshje tregtare për të cilën Britania do të bisedojnë me UE-në nëse del nga ai bllok do të mund të përmbajë liri pa mundësi të lëvizjes që të kënaqen kërkesat të UE-së/ kameron, gjithashtu paralajmëroi se në Britani, nëse vendos të dalë nga UE-ja, do t'i jenë të nevojshme vite për të kontraktuar marrëveshje të tilla sepse do të duhet doemos të sigurojë kompanitë britanike edhe më tej të kenë qasje në tregun evropian.

Nëse Britania vendos të dalë referendumi ligjor është këshillëdhënës, por në praktikë është obligues edhe mund të sjellë në dorëheqje të kryeministrit, vlerëson gazeta britanike Gardian.

Nëse Britanikët votojnë për dalje nga UE-ja, Britania do të bisedojë për marrëdhëniet e ardhshme me UE-në në proces të rregulluar me nenin 50 të Marrëveshjes së Lisbonës.

Në bisedimet Britania do të jetë nga një, ndërsa 27 anëtarët nga ana tjetër në vendet edhe për të arrihet marrëveshja, të dyja palët doemos duhet të pajtohen. Në anën e UE-së ajo do të thotë përkrahje të shumicës së kualifikuar të vendeve të cilat mbeten anëtare, përkatësisht të ashtuquajtur shumicë të kualifikuar - më së paku 72% anëtare të cilat paraqesin më së paku 65% nga popullata, si dhe përkrahje të Parlamentit Evropian.

<http://www.europarl.europa.eu/news/en/news>



« Deri tash asnjë vend nuk ka dalë nga Unioni Evropian, ndërsa më shumë vende evropiane jashtë bllokut zbatojnë reforma të vështira në ekonomi dhe administratë që të hynë në Union »

LUBJANA - QYTETI I GJELBER EVROPIAN PER VITIN 2016



« Prej qyteti ku paraprakisht dominonte transporti me automjete, në fokus të Lubjanës janë transporti publik, rrjetet për këmbësorë dhe biçikleta »

Qyteti i Bristollit e dorëzoi titullin i Qyteti të gjelbër evropian Lubjanës në ceremoninë oficiale në Bruksel më 9 shkurt 2016.

Lubjana u bë kryeqyteti i shtatë i cili hyri në Librin e verdhë - album oficial i qyteteve kryesor evropian të gjelbër.

Lubjana është qendër politike, administrative, kulturore dhe ekonomike e Sllovenisë dhe është shtëpi e më shumë se 280.000 banorë. Lubjana e impresiononte xhiron me transformimin të bërë nga qyteti me qëndrueshmëri gjatë 10-15 viteve paraprake, në sferën e transporti lokal dhe rrugët për këmbësorë në qendrën e qytetit.

Prej qytet ku paraprakisht dominonte transporti me automjete, tash në fokus janë transporti publik dhe rrjete të këmbësor dhe biçikleta. Masa më e rëndësishme e cila është miratuar është ndryshimi i regjimit të komunikacionit në arteret kryesore të komunikacionit (Rruga Sllovenska).

Është arritur përparim në rruajtjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të gjelbra edhe në revitalizimin dhe transformimin e braunfild hapësirave. Lubjana, gjithashtu ka treguar përparim në trajtimin e hedhurinave dhe

ujërave të zeza. Qyteti është i përkushtuar në zbatimin e qëllimit 0 zero hedhurina.

Gjiria vërejt se Lubjana paraqet shembull si ndahen përvojat dhe zgjedhjet për menaxhim me katastrofa natyrore. Ajo është treguar më shumë herë në regjionin e Ballkanit gjatë kohës së krizës të paradokohshme me përmybtjet.

Tre të katërtat nga e gjithë territori i Lubjanës janë sipërfaqe të gjelbra. Këto sfera i përfshijë sipërfaqet ujore, pyjore dhe bujqësore.


Lubjana ka zbatuar një sërë të masave të gjelbra urbane gjatë dekadës të kaluar, duke përfshirë mbjellje të më shumë se 2.000 drunj, ndërtimi i pesë parqeve të gjelbra dhe revitalizimi i pendëve në lumin Sava. Më i madh nga këto parqe është Rruga e kujtimeve dhe miqësive, më e gjata me dru aveni në qytet me 7.000 drunj dhe përmendore të shumta, pika të pushimi dhe karakteristika tjera.

<http://ec.europa.eu/environment/>



UE KALENDAR/mars2016

1. Seancë plenare e Parlamentit Evropian, 07-10/03/2016, Strasburg;
2. Konferencë e përkushtuar në ardhmërinë e arsimit të lartë - 09/03/2016, Amsterdam, në korniza të Kryesimit holandez me Këshillin e UE-së;
3. Debat për të rinj e përkushtuar në migrimin %our Europe, Your Say!, 17-19/03/2016, Bruksel, Belgjik;
4. Forum i përkushtuar shoqërisë qytetare dhe përkrrahje të të drejtave njerëzore - 17-18/03/2016, Bruksel, Belgjik;
5. Konferencë në nivel të lartë për siguri globale shëndetësore, 22-23/03/2016, Lion, Francë.



European Union Newsroom
europa.eu

EUROPA Newsroom Calendar

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

March 2016

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			



KUVENDIN I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

UE QENDRA E KUVENDIT

ADRESA 11 Tetor nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

Zyra për përkrahje të Këshillit kombëtar për
euorintegrim

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendre në Kuvend.

Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me UE çështjet.